



Prishtinë, 29 korrik 2022  
Kodi i ZRRE-së: V\_1566\_2022

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 15.3.2 të Ligjit për Energjinë Termike,
- Dispozitat e Nenit 10 të Ligjit për Energjinë,
- Dispozitat e Nenit 11 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes,
- Kërkesën e NQ Termokos të datës 23.02.2022 për shqyrtim dhe aprovimin e dokumentit "Propozim Plan i Zhvillimor 2022-2031 i NQ Termokos SH.A."

në seancën e mbajtur me datë 29.07.2022 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **Aprovohet dokumenti "Plani Zhvillimor i sistemit 2022-2031" i NQ Termokos.**

## A r s y e t i m

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 23.02.2022 ka pranuar kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit "Propozim Plan i Zhvillimor 2022-2031 i NQ Termokos SH.A.". ZRRE ka analizuar dhe shqyrtuar këtë plan duke dhënë komentet dhe udhëzimet për përmirësim dhe strukturim të këtij dokumenti, dhe pas përfshirjes së komenteve dhe udhëzimeve të ZRRE-së në draftin final të dorëzuar me 13.06.2022, ky dokument është proceduar për konsultim publik.
- Në përputhje me kërkesat ligjore, ZRRE me datë 14.07.2022 ka filluar procesin dy javor të konsultimit publik duke publikuar njohtimin dhe Propozim Planin Zhvillimor në ueb faqen e vet zyrtare, me çrast ka ftuar palët e interesit dhe publikun e gjerë për të dhënë komentet – vërejtjet dhe sygjerimet – në këtë dokument. Gjatë konsultimit publik nuk janë pranuar komente nga asnjëra palë e interesit.
- ZRRE ka analizuar dokumentin dhe vlerëson se projektet e përfshira në dokument janë të arsyeshme dhe të nevojshme për funksionimin e sigurt të sistemit të ngrohjes qendrore të Termokosit. Gjithashtu është vlerësuar se Plani Zhvillimor i NQ Termokos përmbush kriteret e kërkuara. Megjithatë, sa i përket projektit për ndërtimin e objektit qendror administrativ të NQ Termokos, Bordi i ZRRE-së, gjatë shqyrtimit tariforë do ta shqyrtoj me kujdes vlerën e paraparë të



investimit dhe do ta pranoj vetëm një vlerë të arsyeshme të këtij investimi dhe në përputhje me planin e realizimit.

- o Duke marr parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së:

  
Ymer Fejzullahu, kryesues

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

  
Lutfije Dervishi, anëtare

  
Garib Buçaj, anëtar

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së